



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nrfaq/Bilstr. <u>173</u>
Data/Datum. <u>27.09.2019</u>
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 27.09.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 962, të datës 13.09.2019, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020, në shumë të përgjithshme prej 12,608,367.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 772 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 5,602,346.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,601,707.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 230,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 299,657.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,874,657.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2021, është në shumë të përgjithshme prej: 12,957,371.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 4,917,261.00€ dhe për vitin fiskal 2022, është në shumë të përgjithshme prej: 13,336,910.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,042,269.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	174
Data/Datum.	03.10.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



Datë: 02.10.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 964, të datës 13.09.2019, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 46, paragrafi 46.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit 2019

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit të 2019, në shumë të përgjithshme prej 4,318,771.44€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,690,192.13€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,885,983.38€;
 - 2.3 Në shëndetësi, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 729,234.35€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 13,361.58€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

